

Data: \_\_\_\_\_

## INFORMACIONI I STANDARDIZUAR PARAKONTRAKTOR I KREDISË KONSUMATORE-MARRËVESHJE PËR FINANCIM SHITJESH- COPIER COMPUTER CENTER

Ky dokument nuk përbën një ofertë ligjore detyruese. Shifrat janë dhënë në mirëbesim dhe janë një prezantim i saktë i ofertës që banka do të bëjë sipas kushteve aktuale të tregut bazuar në informacionin e dhënë. Megjithë këtë, këto shifra mund të luhaten sipas kushteve të tregut. Dhënia e këtij informacioni nuk parasheh detyrimin e kësaj të fundit për të akorduar kredi.

### 1. Emri dhe detajet e kontaktit të bankës

Banka Adresa Numri i Telefonit (*) Adresa e postës elektronike (*) Numri i Faksit (*) Adresa e Web-it	<i>Banka ProCredit SH.A. Rruga Dritan Hoxha, Tirane +355/ 4 2 389 389 Informacion@procredit-group.com Faks: +355/4 233918 / 233880 www.procreditbank.com.al</i>
(*) <i>ky informacion është opsional për Bankën</i>	

### 2. Përshkrimi i karakteristikave kryesore të produkteve të kredisë

Lloji i Kredisë	<b>Kredi Konsumatore- Marrëveshje për financim shitjesh Copier Computer Center</b>
Vlera totale e kredisë dhe monedha ( <i>nënkupton kufirin maksimal ose shumën totale të disponueshme, të kredisë</i> )	Shuma minimale e kredisë konsumatore është 50,000 LEK ose ekuivalenti i saj ne Euro dhe shuma maksimale e kredisë konsumatore është e 100,000 LEK ose ekuivalenti i saj ne Euro. Kreditë konsumatore për individët jepen në LEK/EUR. Nëse kredia jepet në monedhë të ndryshme nga ajo në të cilën gjenerohen të ardhurat e klientit, ai ka të drejtë të kërkojë konvertimin e monedhës së kredisë. Hollësitë për këtë gjë gjenden në seksionin “E drejta e konvertimit të monedhës së kredisë” si dhe tek “shembulli ilustrues për rrezikun e kursit të këmbimit për kredinë në monedhë të ndryshme nga ajo e gjenerimit të të ardhurave”.
Kushtet që rregullojnë tërheqjen e fondeve ( <i>nënkupton si dhe kur do merren paratë</i> )	Kredia disbursohet në llogari me një lëvrim të vetëm. Për kredinë hartohet një plan pagesë që është pjesë e kontratës dhe përmban informacion për këstet mujore, interesat e aplikuar, shumën e kredisë. .
Kohëzgjatja e kontratës së kredisë	Afati maksimal për këto kredi është 36 muaj.
Këstet dhe kur është e mundur mënyra se si do të shlyhen këstet.	Për vlerën e kësteve ju lutemi referojuni planit të pagesës që është pjesë e këtij informacioni parakontraktor. Kësti është i përafërt sepse në planin e pagesës nuk janë përfshirë ditët e pushimeve dhe mungojnë rumbullakimet.
Shuma totale që konsumatori do të ketë për të paguar	Për shumën total ju lutem referojuni planit të pagesës.



<i>(nënkupton shumën e fondeve të mundshme për t'u marrë hua plus interesat dhe kostot e mundshme që lidhen me kredinë..</i>	
<p>Nëse është e aplikueshme</p> <p>Kredia jepet në formën e një pagese të shtyrë për një mall ose shërbim, ose lidhet me furnizimin e mallrave të veçanta ose ofrimin e një shërbimi</p> <p>Emërtimi i mallit/shërbimit</p> <p>Çmimi në para (cash)</p>	<p>Në rast se nga banka ofrohet një kredi në formën e një pagese të shtyrë për një mall ose shërbim ose kredie lidhet me furnizimin e mallrave të veçanta, informacioni për emërtimin e mallit dhe çmimi përkatës i tij gjenden në faturën/ofertën bashkangjitur, e cila është lëshuar nga tregtari.</p> <p>Këto të dhëna janë pjesë përbërëse e kontratës së kredisë për secilin klient në momentin që ata lidhin kontratën përkatëse të kredisë për blerjen e mallit/shërbimit.</p>
<p>Nëse është e aplikueshme</p> <p>Garanci/siguri të nevojshme</p> <p><i>(Përshkrimi i garancisë që do të ofrohet në lidhje me kontratën e kredisë)</i></p>	<p>Nuk është e aplikueshme.</p>

### 3. Kostoja e kredisë

<p>Norma e interesit të kredisë që do të aplikohet në kontratën e kredisë.</p>	<p>Interesi i aplikuar për kredinë konsumatore do të llogaritet në bazë të vitit me 360 (treqind e gjashtëdhjetë ) ditë. Norma e interesit e pandryshueshme vendoset sipas kushteve të kontratës të rene dakord midis palëve.</p> <p>Vlera e interesit çdo muaj do të llogaritet mbi pjesën e mbetur të principalit të kredisë x normën nominale të interesit / 360 ditë * numri i ditëve të muajit për çdo këst.</p> <p>Për këto kredi aplikohet normë interesi e pandryshueshme për të gjithë periudhën e kredisë.</p> <p>Norma e interesit të kredisë është 12% për kreditë në LEK dhe 11% në EUR dhe do të paguhet nga shoqëria tregtare, me të cilën është lidhur marrëveshje për financim shitjesh.</p> <p>Norma e interesit nominal si dhe vlera përkatëse e tij janë të specifikuara në planin e pageses që shoqëron kontratën e kredisë.</p>
<p>Norma efektive e interesit (NEI)</p> <p><i>Është totali i kostos së kredisë për klientin, e shprehur si përqindje vjetore e vlerës së kredisë së dhënë dhe e llogaritur në përputhje me nenin 6 dhe aneksin nr.1 të rregullores nr.59 "Mbi transparencën për produktet dhe shërbimet bankare e financiare"</i></p>	<p>Norma efektive e interesit (NEI) është totali i kostos së kredise për klientin e shprehur si përqindje vjetore e vlerës së kredise së dhënë.</p> <p>Norma e interesit efektiv si dhe vlera përkatëse e tij janë të specifikuara në planin e pageses që shoqëron kontratën e kredisë.</p> <p>Ne rastin e Interesave Fiks:</p> <p>Interesi do të llogaritet në bazë të vitit me 360 ditë (treqind e gjashtëdhjetë) ditë dhe është i pandryshueshem. Vlera e interesit çdo muaj do të llogaritet mbi pjesën e mbetur të principalit të kredise (kryegjese) x interesi vjetor i kredise/360 ditë * numri i ditëve të muajit</p> <p>Shembull: Për një kredi me shumë 1'600'000 Leke, maturitet 36 muaj, interes nominal i pandryshueshem, 12% në vit, komision 2%, vlera totale e interesit është</p>



	<p>318'775 leke. Norma efektive e interesit per kete kredi eshte 14.60 % ne vit (paketa baze).</p> <p>Norma efektive maksimale e interesit: Per Kredite qe levrohen, Banka ProCredit sha aplikon NEI Maksimal brenda limiteve te publikuara nga Banka e Shqiperise.</p>
<p>A është e mundur të përfitohet kredia sipas kushteve të punës në të cilat tregtohet, duke përjashtuar:</p> <p>1-kontratat e sigurimit për kredinë;</p> <p>2-një kontratë tjetër të shërbimeve ndihmëse.</p> <p><i>Nëse kostot e këtyre shërbimeve nuk njihen nga Banka, ato nuk do të përfshihen në NEI.</i></p>	<p>1-Jo, nuk është e mundur.</p> <p>2-Me marrjen e kredisë klienti përfiton shërbime ndihmëse si: llogari rrjedhëse, një kartë debiti, Llogari Kursimi dhe shërbim E_banking. Kostot janë përmendur në rreshtin "Kosto të tjera të lidhura me kredinë", si edhe në kushtet e punës në fuqi të bankës në momentin e aplikimit/hapjes së tyre.</p>
<p>Kosto të tjera të lidhura me kredinë</p> <p><i>Nëse është e aplikueshme</i></p> <p>Mbajtja e një ose më shumë llogarive është e kërkuar për të regjistruar si transaksionet e pagesave ashtu edhe tërheqjet apo transferimet e fondeve nga njëra llogari në tjetrën.</p>	<p>Kredia do të lëvrohet pa komision disbursimi. Çdo klient që do të marrë një kredi të këtij lloji pranë ProCredit Bank duhet të ketë të paktën një llogari rrjedhëse në të njëjtën monedhë si ajo e kredisë në të cilën do të lëvrohet kredia. Klienti paguan komisione si me poshtë:</p> <p>-Nese klienti ka pagesën e plote, ai paguannje komision mirembajtje llogarie prej 700 Leke / 5 Euro mbahet ne baze mujore.</p> <p>-Nese klienti ka paketën e baze ai paguan nje komision mirembajtje llogarie 100 Lekë/ 1 EUR/ e cila mbahet në bazë mujore.. Gjithashtu klienti paguan dhe 200 Lekë/ 2 EUR e cila mbahet në bazë tremujore per kartën e debitit.</p> <p>Klienti pajiset me shërbimin e plote ose bazë ku eshte perfshire llogaria rrjedhese si dhe perfiton nje karte debiti, Llogari Kursimi dhe shërbim E banking</p>
<p>Çdo kosto shtesë që është e detyrueshme për përfitimin e kredisë.</p>	N/A
<p><i>Nëse është e aplikueshme</i></p> <p>Shuma e kostove për përdorim të caktuar të një pagese (p.sh. një kartë krediti).</p>	Nuk eshte e aplikueshme.
<p><i>Nëse është e aplikueshme</i></p> <p>Ndonjë kosto tjetër që rrjedh nga kontrata e kredisë.</p>	<p>N/A</p> <p>Nese behen te aplikueshme, të gjitha kostot, shpenzimet, tarifat, tarifat për këmbim, komisionet duke përfshirë edhe shërbimet juridike, që dalin si rrjedhojë e përgatitjes, negocimit, zbatimit, regjistrimit, përmbushjes, ndryshimit, ruajtjes, mbylljes apo zbatimit të detyrueshëm, duke përfshirë çdo kosto që do të dali si pasojë e rikuperimit të kredisë, apo të ndonjë garancie apo dokumentacioni përkatës do të mbarten nga Kredimarrësit.</p>
<p><i>Nëse është e aplikueshme</i></p> <p>Kushtet, sipas të cilave kostot e sipërpërmendura që kanë të bëjnë me kontratën e kredisë mund të ndryshojnë.</p>	Çdo ndryshim kontraktual behet nepermjet pelqimit me shkrim te te dy paleve, sipas percaktimeve te Kodit Civil te RSH-se.



<p><i>Nëse është e aplikueshme</i> Detyrimi për të paguar shpenzimet noteriale.</p>	<p>Nese behen te aplikueshme , konsumatori mbart detyrimin per te paguar te te gjitha kostot noteriale apo te sherbimeve juridike që dalin si rrjedhojë e përgatitjes, negocimit, zbatimit, regjistrimit, përmbushjes, ndryshimit, ruajtjes, mbylljes apo zbatimit të detyrueshëm, duke përfshirë çdo kosto që do të dali si pasojë e rikuperimit të kredisë, apo të ndonjë garancie apo dokumentacioni përkatës do të mbarten nga Kredimarrësit.</p>
<p>Kostot në rastin e pagesave me vonesë Mungesa e pagesave të kësteve mund të sjellin pasoja të rënda për konsumatorin dhe e bëjnë procesin e mbajtjes së kredisë më të vështirë.</p>	<p>Në rast mospërmbushje për çfarëdo arsye të Kredimarrësit në pagesën e kësteve sipas Kontrates se lidhur midis paleve, Kredidhënësi do të zbatohet per çdo ditë vonese, që nga data e përcaktuar në Planin e Pagesës (shih të bashkangjiturën) një kamate vonese prej 15% n e vit të shumës së pashlyer dhe, pa njoftuar Kredimarrësit, mund të debitojë llogarite e Kredimarrësve me shumat e mësipërme. Kamatevonesat paguhen per këstin/këstet e kredisë qe ne cdo rast përfshijnë vetëm kryegjënë dhe interesin, ne përputhje me përcaktimet e rregullores se Bankes se Shqiperise per Kredine Konsumatore dhe Hipotekore. Shembull Ne rast se kesti i radhes eshte ne shumen 10'000 ( dhjete mije) leke dhe duhet te paguhet ne date 05 Janar dhe kredimarresi nuk e kryen kete pagese ne daten e caktuar ateher ne date 10 Janar ai eshte i detyruar te paguaje vleren prej 10'020.83 ( dhjetemije e njezet pike tetedhjetë e tre)leke e perbere nga 10'000 Leke kesti plus 20.83 leke gjoba per 5 dite e llogaritur si ne vazhdim 10000Leke/ kesti* 15% ne vit/360 dite (gjoba ditore)* 5 dite ne vonese per pagesen e kestit.</p>
<p>E drejta e konvertimit të monedhës së kredisë</p>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Konsumatori ka të drejtë të kërkojë konvertimin e monedhës së kredisë në monedhën në të cilën gjeneron të ardhurat. Konvertimi mund të kryhet bazuar në rezultatet e analizës apo të vlerësimit më të fundit të bankës, mbi monedhën në të cilën konsumatori gjeneron të ardhurat.</li> <li>2. Në rastet e konvertimit të monedhës së kredisë në monedhën në të cilën gjenerohen të ardhurat, sipas pikës 1 të këtij neni, kursi i këmbimit me të cilin do të realizohet konvertimi i monedhës së kredisë, do të jetë kursi zyrtar i bankës në ditën që kryhet konvertimi, nëse nuk përcaktohet ndryshe në kontratë.</li> <li>3. Banka, për kredinë në monedhë të ndryshme nga monedha në të cilën konsumatori gjeneron të ardhurat, njofton këtë të fundit (nëpërmjet një shkrese ose një mjeti të qëndrueshëm komunikimi, sipas formës së përcaktuar në kontratën ndërmjet palëve), në rastet kur, si rezultat i ndryshimit të kursit të këmbimit, vlera e kësteve të rregullta të pagesës rritet me më shumë se 20% nga vlera që do të rezultonte, nëse do të aplikohet kursi i këmbimit midis monedhës së kredisë dhe monedhës në të cilën konsumatori gjeneron të ardhurat, në datën e nënshkrimit të kontratës.</li> <li>4. Njoftimi i përcaktuar në pikën 3 të këtij neni përmban informacion për konsumatorin, mbi rritjen në vlerën e kësteve të pagueshme prej tij dhe të drejtën që ekziston për ta konvertuar tepricën e mbetur të kredisë në monedhën në të cilën gjeneron të ardhurat, siç parashikohet në pikat 1 dhe 2 të këtij neni.</li> </ol>



Opsionet për zbutjen e rrezikut të kursit të këmbimit	Opsionet që mund të ofrojë banka për zbutjen e rrezikut ndaj kursit të këmbimit kanë të bëjnë me përputhjen e monedhës së financimit me monedhën e të ardhurave të klientit bazuar në analizën financiare.
---	--

#### 4. Aspekte të tjera të rëndësishme ligjore

<p>E drejta për t'u tërhequr</p> <p><i>Konsumatori ka të drejtë për t'u tërhequr nga kontrata e kredisë brenda një periudhe kohore prej 14 ditësh kalendarike.</i></p>	<p>Po.</p> <p>Kredimarrësi ka të drejtën për t'u tërhequr nga kontrata e kredisë brenda një periudhe kalendarike 14 ditore, nga dita e nënshkrimit të kontratës së kredisë, pa detyrim justifikimi duke paguar vetëm kryegjënë dhe interesin e akumuluar për ditët përkatëse.</p> <p>Përpara ushtrimit të kësaj të drejte kredimarrësi njofton me shkrim bankën për synimin e tij (brenda afatit prej 14 ditësh) për t'u tërhequr nga kontrata e kredisë. Banka njofton klientin për vlerën e kredisë dhe interesin për t'u kthyer për ditët përkatëse. Interesi llogaritet mbi bazën e normës së interesit të rënë dakord dhe nuk do të paguhet asnjë penalitet tjetër në ushtrimin e kësaj të drejte, me përjashtim të shpenzimeve të tjera të bankës të krijuara nga veprime me palë të treta. (kur është rasti shpenzime noteriale, hipoteke etj).</p> <p>Në rastet kur Kredidhënësi dhe/ ose një palë e tretë ofron një shërbim ndihmës në lidhje me kontratën e kredisë, në bazë të një kontrate midis palës së tretë dhe Kredidhënesit, Kredimarrësi nuk do të ketë më detyrime nga kontrata e shërbimit ndihmës, nëse ai (Kredimarrësi) tërhiqet nga kontrata e kredisë, në përputhje me përcaktimet e mësipërme si edhe me përcaktimet e gjendura në kontratën e kredisë.</p> <p>Për më tepër konkretizim, shërbimet ndihmëse (ancillary) janë shërbime të lidhura me kontratën e kredisë të tilla si: bankingu elektronik (internet banking, mobile banking), shërbimi i kartës, etj. apo të tjera të cilat i ofrohen klientëve kredimarrës në formën e paketave të agreguara (bundling practice), të përcaktuara në nenin 9/2 të rregullores së Bankës së Shqipërisë nr. 48/2015 “Për kredinë konsumatore dhe kredinë hipotekare”.</p>
<p>Shlyerja (Pagesa) e kredisë para afatit të maturimit.</p> <p><i>Konsumatori ka të drejtë të kryejë në çdo kohë, para afatit të maturimit shlyerjen e pjeshme ose të plotë të kredisë.</i></p>	<p>Konsumatori ka të drejtë të kryejë në çdo kohë, para afatit të maturimit, shlyerje të pjeshme ose të plotë të detyrimeve të tij të lindura nga kontrata e kredisë. Në këtë rast, banka duhet të bëjë reduktim të kostos totale të kredisë. Ky reduktim konsiston në uljen e shumës së interesit dhe shpenzimeve të tjera të aplikueshme për shumën e kryegjësë së shlyer para afatit të maturimit, siç është rënë dakord në kontratën e kredisë për të tilla raste.</p> <p>Ne rast se Kredimarrësi do të kerkojë me ane të një kerkese me shkrim, të shlyejë kredinë, përpara afatit të specifikuar në kontratë dhe në rast se Kredidhënesi është dakord,</p> <p>Kredimarrësi është i detyruar të paguaj në favor të Kredidhënesit :</p>



	<p>a) nje komision prej 1% te shumes se kredise , nese periudha midis shlyerjes para afatit dhe maturimit te kredise eshte mbi 1 vit.</p> <p>b) nje komision prej 0.5% te shumes se kredise , nese periudha midis shlyerjes para afatit dhe maturimit te kredise nuk kalon 1 vit.</p> <p>c) Nje komision 0% te shumes se kredise per rastet: (i) kur shlyerja e kredise realizohet ne baze te nje kontrate sigurimi ne rast te ndodhjes se ngjarjes se percaktuar ne kontraten e sigurimit (ii) kur shlyerja e kredise para afatit i perkon nje periudhe per te cilen norma e kredise nuk eshte fikse.</p> <p>Ne rast te pageses se menjehershme te gjashte ose me shume kesteve se bashku, Kredidhenesi konsideron shlyerjen e pjesshme te kredise dhe rillogaritjen e kryegjese se mbetur ne nje plan te ri pagese.</p> <p>Kjo procedure eshte e mundshme ne datat ndermjet pageses se kesteve sipas planit te pageses dhe nga shuma e sjelle do te zbritet fillimisht interesi i akumuluar.</p> <p>Nese Kredimarresi vjen ne daten e pageses se kestit te kredise, do te paguhet fillimisht kesti me i afert qe ka daten e shlyerjes dhe me pas shuma e mbetur qe do te shkoje per pagese te pjesshme do te duhet te jete minimumi sa shuma e 6 (gjashte) kesteve.</p> <p>Ne te dyja rastet pasi te jene zbritur keto detyrime, pjesa tjeter e pageses se Kredimarresit, do te shkoje e gjitha per shlyerjen e kryegjese. Pjesa e mbetur e kredise do te rillogaritet dhe Kredimarresi do te marre planin e ri te pageses.</p> <p>Shembull: Per kredine me shume 3 000 000 Leke, maturitet 24 muaj, interes nominal 15% ne vit, kesti mujor eshte 146 000 Leke, i cili paguhet cdo date 15 te muajit. Ne daten 15 te muajit klienti vjen per te paguar kestin e 14-te. Kredimarresi ka sjelle 1 022 000 Lek, nga te cilat 146 000 lek duhet te shkojne fillimisht ne pagesen e kestit te rradhes, pas te cilit kredia e mbetur eshte 1 342 990 Lek.</p> <p>Pjesa e mbetur e shumes se sjelle prej 876 000 Lek eshte sa 6 keste kredie dhe me kerkese te kredimarresit kalohet per shlyerje te pjesshme. Nga kjo shume mbahet komision 3%, e barabarte me 26'280 Lek dhe diferenca 849'720 ul kryegjese ne 493'270 Lek, per te cilen kredimarresi do te marre nje plan te ri pagese per te njejtin afat te mbetur me nje kest mujor me te ulet, ose per te njejtin kest nje afat me i shkurter.</p>
<p><i>Nëse është e aplikueshme</i> Banka ka të drejtën e kompensimit, në rastin e shlyerjes së kredisë para afatit të maturimit.</p>	<p>Banka ka të drejtën për një kompensim të drejtë dhe objektiv, sipas përcaktimit në kontratën e kredisë. Kompensimi në këtë rast nuk mund të tejkalojë humbjet financiare të bankës, të cilat duhet të jenë të justifikuar nga kosto të mundshme të lidhura direkt me shlyerjen/et e kredisë para afatit</p>
<p>Informimi në rast refuzimi të kredisë</p>	<p>Banka informon konsumatorin, menjëherë pas refundimit të shqyrtimit të aplikimit për kredi , dhe pa komisione, nëse një aplikim për kredi është refuzuar, duke i vënë në dispozicion arsyet mbi të cilat është bazuar ky refuzim. Kjo nuk aplikohet nëse dispozitat e këtij informacioni janë të ndaluara nga ligjet e Republikës së Shqipërisë.</p>



E drejta e pajisjes me kopjen e projektkontratës së kredisë	<p>Konsumatori ka të drejtën për t'u pajisur, me kërkesën e tij dhe pa pagesë, me një kopje të projektkontratës së kredisë. Projekt kontrata (drafti i saj) është kopje e pafirmosur dhe e pavulosur e kontratës së kredisë me të gjithë elementët që përmban ajo kontratë dhe nuk ka efekte detyruese për palët.</p> <p>Në rast se banka nuk është e gatshme që të vijojë me nënshkrimin e kontratës së kredisë me klientin në kohën që klienti bën kërkesën për t'u pajisur me kopjen e projekt kontratës, kjo e drejtë e klientit nuk do të zbatohet.</p>
Mënyra e njoftimit, si dhe mënyra e marrjes së pëlqimit të konsumatorit në rastin e ndryshimeve të kushteve, të cilat sjellin pasoja në bazë të kontratës.	Të gjitha njoftimet, komunikimet midis palëve do të bëhen me shkrim, dhe do t'i dergohen palës tjetër personalisht ose me postë të regjistruar, në adresën e specifikuar ose në adresa të tjera ku pala në fjalë e përcakton dhe njofton me shkrim palën tjetër në lidhje me këtë adresë, si dhe me bërjen publike të tyre në ambientet e degëve të Bankës, në faqen e internetit ose me mjetet e komunikimit masiv. Gjithashtu do të aplikohen edhe njoftimet me email, me mesazh në shërbimin e-banking, në aplikacionin mobile banking dhe forma të tjera njoftimi me mjete të qëndrueshme të komunikimit.
Skema e brendshme e ankimit të konsumatorit kundrejt bankës.	<p>Klienët mund të depozitojnë ankesën e tyre:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>-Në të gjitha degët e bankës.</li> <li>-Në adresën postare: ProCredit Bank, Zyrat Qendrore, Departamenti Retail (Qendra e Kontaktit), Rr.Dritan Hoxha, pranë pallatit të sportit "Asllan Rusi", Tiranë, Shqipëri.</li> <li>-Në adresën elektronike: <a href="mailto:KujdesindajKlientit@procredit-group.com">KujdesindajKlientit@procredit-group.com</a>; <a href="mailto:informacion@procredit-group.com">informacion@procredit-group.com</a>;</li> <li>-Në faqen zyrtare të bankës në internet.</li> </ul> <p>Përgjigjja zyrtare i komunikohet klientit brenda 15 ditëve pune nga dita e dorëzimit të ankesës.</p>
Periudha kohore gjatë së cilës Banka ka detyrime që rrjedhin nga informacioni parakontraktor.	Ky informacion është i vlefshëm për 10 ditë.
Përpunimi i të dhënave personale	Ju informojmë se të dhënat tuaja personale përpunohen nga ana e bankës në përputhje me ligjin "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale". Të dhënat personale përpunohen për qëllimet e vlerësimit dhe verifikimit të sjelljes së bankës në treg nga Autoriteti i Konkurrencës, kur është e nevojshme. Kjo përfshin aksesin dhe përpunimin e të dhënave tuaja nga Autoriteti i Konkurrencës, në rast të monitorimit, hetimit paraprak ose hetimit të thelluar ndaj bankës.

Në kuptim të rregullores së Bankës së Shqipërisë "Për kredinë konsumatore dhe kredinë hipotekare" termi kredia konsumatore do të ketë të njëjtin kuptim të përcaktuar në nenin 44 të ligjit nr. 9902, datë 17.4.2008, "Për mbrojtjen e konsumatorëve", i ndryshuar duke përfshirë kreditë si më poshtë:

- Kredi konsumi (blerje pajisje shtëpie, kredi për edukim etj)
- Kredi për blerje makine
- Kredi Green Investment (blerje pajisje për efikasitetin e energjisë etj)



Kredia e investimit dhe kredia green investment me objekt rinovimin apo rikonstruksionin e një pasurie të paluajtshme rezidenciale (shtëpi, apartament ose truall ku do të ndërtohet një godinë banimi) nuk përfshihet në kredinë konsumatore.

**Konsumatori**  
(Konfirmon marrjen e informacionit parakontraktor)

\_\_\_\_\_  
(Emër Mbiemër, Nënshkrimi)

Data: \_\_\_\_\_

**SHEMBULL ILUSTRUES PËR RREZIKUN E KURSIT TË KËMBIMIT PËR KREDINË NË MONEDHË TË NDRYSHME NGA AJO E GJENERIMIT TË TË ARDHURAVE**

Tekst sqarues për konsumatorin

Kredidhënia në një monedhë të ndryshme nga ajo në të cilën gjenerohen të ardhurat, për konsumatorin që nuk është i mbrojtur nga rreziku i kursit të këmbimit, shoqërohet me rreziqe të konsiderueshme. Për shembull, një nënçmim i fortë i kursit të këmbimit do të shkaktonte vështirësi në aftësinë e konsumatorit për të shlyer kredinë. Këto vështirësi mund të çonin në dështimin e konsumatorit për të shlyer kredinë, në kthimin e kredisë në statusin “me probleme” dhe mund të përfundonin në fillimin e procedurave për ekzekutimin e detyrimit nga ana e bankës.

Ky aneks përmban një shembull me natyrë ilustruese dhe informuese, dhe nuk përfaqëson një pritshmëri apo angazhim ligjor nga kredidhënësi apo kredimarrësi.

Konsumatori që aplikon për kredi në një monedhë të ndryshme nga ajo në të cilën gjeneron të ardhurat, nëpërmjet nënshkrimit të këtij dokumenti vërteton se:

- 1) e ka marrë këtë dokument nga banka përpara lidhjes së kontratës së kredisë;
- 2) e ka kuptuar shembullin dhe efektet e mundshme nga lëvizjet në kursin e këmbimit;
- 3) është i bindur që mund të përballojë rreziqet që shoqërojnë kredinë.

Dokumenti i nënshkruar është pjesë e analizës që bën banka për dhënien e kredisë të konsumatorit, por dokumenti i nënshkruar nuk e detyron bankën për dhënien e kredisë dhe as nuk e redukton përgjegjësinë që ka banka për të kryer analizën e saj të plotë për qëndrueshmërinë financiare të aplikuesit për kredi.

Të dhëna për kredinë në monedhë të ndryshme nga monedha e gjenerimit të të ardhurave.



Kredimarrësi: Klienti X  
 Kredidhënësi: Banka ProCredit SH.A.  
 Lloji i kredisë (hipotekare/konsumatore): Konsumatore  
 Kohëzgjatja e kredisë: 36 muaj  
 Vlera e kredisë: 10'000.00 Njësia monetare: Euro  
 Kursi i këmbimit, në datën e vlerësimit të planit ilustrues: 1 Euro = 96 Lek  
 Kundërvlera e kredisë në monedhën në të cilën gjeneron të ardhurat: 960'000.00 Lek  
 Norma vjetore nominale e interesit: 9 %  
 Komisioni i disbursimit: 2 %  
 Kesti mujor: 319 euro  
 Norma efektive e interesit: 11.24% (pakete baze) dhe 11.64% (pakete e plote)  
 Indeksi orientues/norma referencë: n/a Marzhi: n/a  
 Të ardhurat mujore (bruto/neto) të huamarrësit në monedhën në të cilën gjeneron të ardhurat (mesatare e 3 viteve të fundit): 80'000.00 lek/muaj

Tabelë 1: Këstet e kredisë dhe raporti i vlerës së kësteve të kredisë ndaj të ardhurave (në %), sipas skenarëve të rrezikut të ndryshimit të kursit të këmbimit.

Skenari	Vlera e Kësteve e shprehur në monedhën e kredisë (a)	Kundërvlera e Kësteve në monedhën në të cilën gjenerohen të ardhurat (b)	Të ardhurat (mesatare mujore të 3 viteve të fundit) në monedhën në të cilën ato gjenerohen (c)	Raporti i vlerës së kësteve ndaj të ardhurave (d) = (b)/(c)
Kursi i këmbimit nuk ndryshon	319 EUR	319 * 96 = 30'624.00 Leke	80,000 Leke	38.28%
Nënçmim i kursit të këmbimit me 5% (1)	319 EUR	319 * 100.8 = 32'155.20	80'000.00 Leke	40.19%
Nënçmim i kursit të këmbimit me 20%	319 EUR	319 * 115.2 = 36'748.80 Leke	80'000.00 Leke	45.94%

Shënime:

- Në kolonën (a) banka paraqet vlerën e kësteve, sipas planit të amortizimit të kredisë, në monedhën në të cilën është marrë kredia.
- Kolona (b) paraqet informacion mbi vlerën e kësteve sipas planit të amortizimit të kredisë, të konvertuar në monedhën në të cilën konsumatori gjeneron të ardhurat, në rastet kur kursi i këmbimit nuk ndryshon (kursi në këtë rast është i njëjtë me kursin e këmbimit të datës kur i paraqitet ky shembull ilustrues konsumatorit) dhe në rastet kur kursi i këmbimit nënçmohet me 5% ose 20%.
- Kolona (c) paraqet informacion mbi të ardhurat mujore të 3 viteve të fundit të deklaruara nga konsumatori, të shprehura në monedhën në të cilën këto të ardhura gjenerohen.
- Kolona (d) paraqet raportin e kësteve (i shprehur në monedhën në të cilën gjenerohen të ardhurat) me të ardhurat e konsumatorit (mesatarja mujore e tre viteve të fundit).

Konsumatori  
(Konfirmon marrjen e këtij shembulli ilustrues)

(Emër, Mbiemër, Nënshkrimi)